



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna Hani i Elezit / Municipality of Hani i Elezit



01.Nr ____/2010

Dt. 02.08.2010

Në mbështetje të nenit 40 pika 1, neni 73, i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, neni 4.2 të Udhëzimit Administrativ Nr.2008/10 për organizimin dhe funksionimin e Komiteteve Konsultative, neni 30 i Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës shpallë:

K O N K U R S

Për anëtarë në Komitetet Konsultative të Komunës së Hanit të Elezit

- 1. Komiteti për Arsim, Kulturë, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (5 anëtarë).**
- 2. Komiteti për Zhvillim Ekonomik, Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Ambientit (5 anëtarë).**
- 3. Komiteti për Shërbime Publike dhe Emergjencë (5 anëtarë).**

Detyrat dhe përgjegjësit:

- Japin propozime për rregullore të ndryshme sipas lëmive përkatëse.
- Japin mendime dhe ide rreth iniciativave që i ndërmer Kryetari i Komunës, Komitetet e përhershme apo Kuvendi i Komunës në fushat përkatëse.
- Paraqesin pikëpamje dhe mendime të qytetarëve te Kryetari i Komunës dhe Kuvendi i Komunës.
- Paraqesin propozime për zgjidhjen e problemeve të identifikuar.
- Paraqesin ide apo propozime për hulumtime të ndryshme.

Mandati:

-Mandati i parë i anëtarëve të Komiteteve Konsultative është 3 (tre) vjeçar në baza të rregullta ku 1/3 (një e treta) e anëtarëve duhet të ndërrohet çdo vit.

Anëtarët e Komiteteve Konsultative mund të shërbejnë më së shumti për dy mandate të njëpasnjëshme si anëtarë të atyre komiteteve.

Kompensimi:

-Për punën e tyre në Komitetet Konsultative, anëtarët e këtyre komiteteve do të kompensohen konform me dispozitat e nenit 9 të Udhëzimit Administrativ Nr.16/2008 për pagesën e Stafit politik në Komuna.

Kushtet:

Të drejtë për të marrë pjesë në konkursin për anëtarësim në Komitetin Konsultativ kanë të gjithë qytetarët dhe përfaqësuesit e organizatave joqeveritare të Komunës së Hanit të Elezit të cilët janë njohës të fushave përkatëse.

1. Përfaqësimi gjinor në Komitetin Konsultativ duhet të jetë në kuotën e 30%.
2. Kandidati për anëtar në Komitetin Konsultativ duhet të jetë banor i Komunës së Hanit të Elezit.
3. Përgatitja profesionale- përparësi.

Dokumentet e kërkuara:-

- CV
- Diploma
- Çertifikata e lindjes
- Kopje e letërnjoftimit
- Çertifikata e vendbanimit

Kandidatët të cilët konkurrojnë do t'i nënshtrohen intervistimit.

Afati për dorëzimin e dokumenteve të kërkuara është 30 ditë nga dita e shpalljes në gazetatat publike.

Dokumentet e pa kompletuara dhe ato që arrijnë pas kësaj date nuk do të shqyrtohen. Dorëzimi i dokumenteve të kërkuara mund të bëhet çdo ditë pune nga ora 9:00 deri 15:30, në Komunë përkatësisht në zyrën e pranimit.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Menduh Vlasi